



TETË MUAJ PAS ZGJEDHJEVE, KONSTITUOHET KUVENDI I KOSOVËS

FAQE 5



Gjashtë muaj pas seancës së parë konstituive, deputetët e legjislaturës së nëntë të premten 10 tetorit kanë arritur ta konstituojnë Kuvendin e Kosovës.

Pas zgjedhjes së nënkryetarit të pestë të Kuvendit të Kosovës, kryeparlamentari Dimal Basha e shpalli Kuvendin e Kosovës të konstituuar. Nenad Rashiq, nga

partia Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, u zgjodh nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, pas dështimit të nëntë propozimeve të Listës Serbe

PREMTIMET NË FUSHATA DIKUR DHE TASH: ÇFARË KA NDRYSHUAR?

F. 3



MILIONA PËR STUDENTËT, PACIENTËT PRESIN NË SPITALE PA PAJISJE DHE STAF

F. 5



HAPET APLIKIMI PËR MBËSHETJEN E STUDENTËVE ME NGA 100 EURO

F. 8

SPORT



20 KOMBËTARET QË E KANË SIGURUAR TASHMË KUPËN E BOTËS

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHEFJA E KE-së JAVËN E ARDHSHME VJEN NË KOSOVË

PRISHTINË, 10 TETOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, më 15 tetor do të qëndrojë në Kosovë në kuadër të një turneu kur do t'i vizitojë edhe shtetet e tjera të rajonit. Sipas agjendës së publikuar nga Komisioni Evropian, në Kosovë ajo do të takohet me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti. Në agjendën e publikuar nuk bëhet me dije se për çfarë çështjesh do të diskutojë shefja e KE-së me Osmanin dhe Kurtin. Turneun në Ballkanin Perëndimor shefja e krahut ekzekutiv të Bashkimit Evropian do ta nisë më 13 tetor në Tiranë,

ku do të takohet me presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj, kryeministrin Edi Rama si dhe do të marrë pjesë në ceremoninë hapëse të Forumit për Investime BE-Ballkani Perëndimor. Po më 13 tetor Von der Leyen do ta vizitojë edhe Tivatin e Malit të Zi, ku do të takohet me presidentin Jakov Millatoviq dhe kryeministrin Millojko Spajiq. Një ditë më pas ajo do të qëndrojë në Bosnjë-Hercegovinë, ku do të takohet me anëtarët e Presidencës së vendit, me kryetaren e Këshillit të Ministrave, Borjana Krishto si dhe do ta vizitojë Qendrën Memoriale për Srebrenicën.

Para qëndrimit në Kosovë, më 15 tetor, Von der Leyen do të takohet në Beograd me presidentin serb Aleksandar Vuçiq dhe kryeministrin Gjuro Macut. Pas qëndrimit në Kosovë ajo do të përmbyllë vizitën në rajon në Maqedoni të Veriut, ku do të takohet me presidenten maqedonase Gordana Silanovska-Davkova, kryeministrin Hristijan Mickoski dhe kryetarin e Kuvendit, Afrim Gashi. Herën e fundit që Von der Leyen kishte qëndruar në Kosovë ishte në tetor të vitit të kaluar, kur kishte folur për masat ndëshkuese që blloku evropian i

ka vendosur ndaj Kosovës. Që atëherë blloku ka njoftuar se ka nisur heqjen e disa masave që u vendosën më 2023 për shkak të rritjes së tensioneve në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. Gjatë asaj vizite shefja e KE-së kishte lavdëruar Kosovën për punën që kishte bërë në agjendën e reformave për Planin e Rritjes të BE-së. Megjithatë, Kosova nuk ka përfituar nga ky plan pasi për shkak të mungesës së krijimit të institucioneve deri më tani nuk janë miratuar marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare. Plani i Rritjes prej 6 miliardë eurosh përfshin investime dhe



reforma për vendet e Ballkanit Perëndimor si pjesë e agjendës reformuese për periudhën 2024-2027. Nga kjo shumë, dy miliardë janë në formë granti, ndërsa katër miliardë euro janë në formë kredie me këste shumë të favorshme. Plani synon t'i përshpejtojë reformat dhe t'i përgatisë shtetet e Ballkanit Perëndimor për anëtarësim.

TRUMPI THOTË SE PENGJET DO TË LIROHEN JAVËN E ARDHSHME

Uashington, 10 tetor - Presidenti amerikan Donald Trump tha se do të tentojë të shkojë në Egjipt për nënshkrimin e marrëveshjes së armëpushimit në Gazë, duke shtuar se pret që Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja - t'i lirojë pengjet të hënën ose të martën. Duke folur gjatë mbledhjes së kabinetit të enjten, Trumpi tha se marrëveshja në mes të Izraelit dhe grupit radikal palestinez i "ka dhënë fund luftës në Gazë" dhe do të çojë në paqe më të gjerë në Lindjen e Mesme. "Kemi arritur lirinë e të gjitha pengjeve të mbetura dhe ata duhet të lirohen të hënën ose të martën", tha Trump gjatë mbledhjes me sekretarët e tij në Shtëpinë e Bardhë.

Por, Trumpi shtoi se trupat e disa pengjeve të vdekura do të jetë "vështirë që të gjenden". Trumpi njoftoi për planet për të udhëtuar për në Lindjen e Mesme edhe para se ta zbulonte fazën e parë të planit të paqes të mërkurën, por tha se po bëhen përgatitje për një ndalesë të mundshme në Egjipt. Presidenti egjiptian Abdel Fattah al-Sisi tha më herët se e kishte ftuar homologun e tij amerikan të marrë pjesë në një "ceremoni që do të mbahet në Egjipt" për marrëveshjen e fazës së parë të armëpushimit. Trumpi tha, po ashtu, se pret që ta vizitojë Izraelin, duke shtuar se është ftuar t'i adresohet Parlamentit izraelit. Pas mbledhjes së kabinetit, nga Zyra Ovale Trumpi tha për gazetarët se do të niset drejt



Lindjes së Mesme të dielën. Presidenti amerikan ka dhënë pak hollësi për fazën e dytë të marrëveshjes së paqes dhe për të ardhmen e Gazës. Ai tha se "do të ketë çarmatosje dhe tërheqje", që duket se është

referencë për kërkesën e Izraelit që Hamasi të çarmatoset dhe thirrjeve të grupit radikal palestinez që Izraeli t'i tërheqë trupat nga Gaza. Trumpi shtoi se Gaza "ngadalë do të rindërtohet", duke lënë të

kuptohet se shtetet arabe do të ndihmojnë në rindërtim, por edhe ka mundësi që ato të marrin pjesë në përpjekjet paqeruajtëse. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, njoftoi të mërkurën vonë se Izraeli dhe Hamasi e arritën marrëveshjen e shumëkërkuar për armëpushim në Gazë dhe për lirinë e pengjeve, sipas planit të tij për t'i dhënë fund luftës dyvjeçare në enklavën palestineze. Lufta në Gazë nisi më 7 tetor 2023, pasi Hamasi sulmoi jugun e Izraelit duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer 251 të tjerë. Si pasojë e ofensivës izraelite, në Gazë janë vrarë më shumë se 67 000 palestinezë dhe banorët po përballen me krizë humanitare.

Mbretëria e Bashkuar konfirmon "angazhimin për stabilitet në Ballkanin Perëndimor"

PRISHTINË, 10 TETOR - Sekretarja e Jashtme Yvette Cooper ka konfirmuar angazhimin e Mbretërisë së Bashkuar për stabilitet në Ballkanin Perëndimor gjatë samitit të nivelit të lartë në Irlandën e Veriut. Ajo mirëpriti ministrat e Jashtëm nga shtetet e Ballkanit Perëndimor nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Shqipëria. Në takimet më 8 dhe 9 shtator në kuadër të Procesit të Berlinit, Kosova është përfaqësuar nga ministrja në detyrë për Punë të Jashtme dhe Diasporë e Kosovës, Donika Gërvalla. Ndërkaq, Serbia u përfaqësua nga ministri i Jashtëm, Marko Gjuriq. Në takimin në Kështjellën Hillsborou morën pjesë edhe



aleatët evropianë, sikurse Franca, Austria, Greqia dhe Italia. Në fillim të takimit më 9 shtator, Cooper dhe ministri i Jashtëm gjerman, Johann Wadephul, mirëpritën përfaqësuesit e Ballkanit Perëndimor. Brenda Kështjellës, Cooper tha se ky vend është simbol i paqes, përparimit dhe pajtimit pas procesit historik të paqes me Irlandën e Veriut në fund të

viteve '90. Ajo u tha të pranishmëve se Mbretëria e Bashkuar "ka një angazhim të kamotshëm dhe të qëndrueshëm për stabilitetin, sigurinë dhe mirëqenien në Ballkanin Perëndimor". "Ne e dimë se siguria në Ballkanin Perëndimor ndikon në sigurinë e gjithë Evropës dhe në sigurinë tonë këtu në Mbretërinë e Bashkuar", tha ajo. "Dhe është një nder i madh të udhëheqës këtu vit takimin e ministrave të Jashtëm të Procesit të Berlinit dhe të jesh në gjendje ta presim këtë këtu në Irlandën e Veriut, në një vend kaq historik". Cooper iu referua "diskutimeve kuptimplota" të natës së kaluar mbi përvojat e Irlandës së Veriut, pothuaj tri dekada pas Marrëveshjes së Belfastit. Ajo, po ashtu, tha se kanë kaluar

30 vjet nga Marrëveshja e Dejtonit më 1995, e cila i dha fund luftës në Bosnjë, dhe tubimi në Kështjellën Hillsborou, sipas saj, është "një simbol i paqes, përparimit dhe pajtimit". Para samitit, Mbretëria e Bashkuar premtoi financim për forcimin e sigurisë së kufijve dhe trajnime për zbatimin e ligjit në Kosovë, si dhe mbështetje për përforcimin e mbrojtjes kibernetike kundër kërcënimeve të ndikimit nga Rusia në rajon. Cooper, gjithashtu, njoftoi për investime për projekte që synojnë ta luftojnë trafikimin e njerëzve në Ballkanin Perëndimor dhe rajone të tjera kyçe. Ballkani Perëndimor është rrugë kryq përmes së cilës

migrantët udhëtojnë për në Bashkimin Evropian dhe Mbretërinë e Bashkuar. Vetëm vitin e kaluar janë regjistruar pothuajse 22 000 kalime të paligjshme në kontinent, sipas shifrave të Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar. Bashkësia ndërkombëtare prej vitesh bën përpjekje ta rrisë bashkëpunimin në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor të cilat kanë kaluar nëpër luftëra të përgjakshme në vitet '90, dhe t'i përafrojë ato me Bashkimin Evropian. Për këtë qëllim ka iniciuar edhe Procesin e Berlinit në vitin 2014, i cili përfshin të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Çdo vit përfaqësuesit e tyre mbledhen në samite, së bashku me ata të vendeve partnere, dhe bëjnë marrëveshje dhe deklarata.

PREMTIMET NË FUSHATA DIKUR DHE TASH: ÇFARË KA NDRYSHUAR?

Një raport i Institutit për Hulumtime të Avancuara - GAP tregon se numri i premtimeve që kanë bërë bashkërisht kandidatët për kryetarë komunash në Kosovë është rritur secilën herë e më shumë. Nga 129 premtime për mandatin 2007-2009, numri ka arritur në mbi 1 800 për mandatin 2021-2025. Por, sa kanë ndryshuar ndër vite zotimet dhe si ka ndërruar qasja e kandidatëve për kërkimin e votës?

Prishtinë, 10 tetor - Premtimet në fushatën për zgjedhjet lokale të 12 tetorit ndryshojnë: nga vendosja e sistemit të kanalizimit në një fshat a qytet dhe ndërtimi i bibliotekave deri te krijimi i një linje të re prodhuese “Made in Mitrovica” apo ndërtimi i sistemit të tramvajit në Prishtinë e i atij të teleferikut në Prizren.

Me gjithë llojllojshmërinë e premtimeve dhe numrin e konsiderueshëm - meqë 206 persona kandidojnë për kryetarë në 38 komuna, ndërsa mbi 5 000 për asamblistë - njohësit e çështjeve politike vlerësojnë se nuk duhen ngritur paralele mes tyre, sepse secila komunë i ka nevojat e veta.

Por, Visar Ymeri, drejtor ekzekutiv i Institutit për Politika Sociale “Musine Kokalari”, vëren se fushatat janë bërë shumë më racionale: “Tani po flitet shumë më shumë për cilësinë e arsimit, për mësimin tërëditor, flitet shumë më shumë për hapësirat e gjelbra, për parqet që mungojnë, dhe jo vetëm për rrymën, kanalizimin, ujin e pijes, asfaltimin e rrugëve, tema që kanë dominuar në fushatat e kaluara”, thotë Ymeri për Radion Evropa e Lirë (REL).

Edhe Bekim Salihu nga Instituti për Hulumtime të Avancuara - GAP përmend për REL-in që kandidatët për kryetarë nuk bëjnë më premtime të ngjashme me ato të viteve më parë - sikurse pavarësia, përmirësimi i situatës me energji elektrike, apo çështja e vizave - që s’kanë qenë kurrë përgjegjësi e pushtetit lokal. “Në përgjithësi, kandidatët duket se e kanë kuptuar se cilat janë kapacitetet e tyre ligjore dhe buxhetore, në kuptim të komunave, dhe premtimet po jepen brenda kësaj natyre. Nuk po lexoj më premtime të ekzagjeruara siç kanë qenë në të kaluarën”.

Zotimet vs. realiteti

Bazuar në të dhënat e Institutit GAP, në mandatin 2021-2025 janë përmbushur 51 për qind e premtimeve në komunat e Kosovës, ndërsa 21 për qind as



nuk kanë filluar si projekte. Për Ymerin, kjo shifër nuk është e kënaqshme, ndonëse nuk mund të analizohet vetëm në aspektin statistikor. “Mund të ketë kryetar që del shumë mirë në realizimin e premtimeve, por kur të lexohen premtimet e realizuara, e shoh që, megjithatë, edhe pse janë realizuar, kapaciteti i tyre për ta transformuar qytetin është i vogël. Ka kryetarë që kanë dalë me zotime të mëdha për ta transformuar qytetin, siç ka qenë rasti i kryetarit të Prishtinës, apo i atij të Mitrovicës së Jugut, dhe disa tjerë që kanë qenë më modestë në zotimet e tyre”. Sipas Salihut, janë edhe disa aspekte të tjera që duhen pasur parasysh kur flitet për përmbushje zotimesh në mandatin që kryetarët po e lënë pas. “Nisja e mandatit në periudhë të pandemisë, pastaj përpjekja për t’u rikuperuar nga kjo periudhë, më pas inflacioni dhe lufta në Ukrainë, që ka

ndikuar shumë në çmimet dhe ka ndikuar tek ecuria e punëve në teren, ka pasur probleme të mëdha me çështje të përmbarimit që kanë ardhur si pasojë e kontratave kolektive dhe deri te bllokimi i fondeve të Bashkimit Evropian, shuarja e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) e kështu me radhë”.

Të dhënat tregojnë se në nivel vendi, komunat kanë shpenzuar rreth 93 për qind të buxhetit, ndërsa rreth 58 milionë kanë mbetur të pashfrytëzuara. Sipas parashikimeve të Ministrisë së Financave për buxhetin e vitit të ardhshëm, disa komuna do të kenë rritje të buxhetit në linjë me ndryshimet që janë bërë në numrin e popullsisë dhe janë reflektuar në shifrat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Prej rreth 3.5 miliardë eurove të buxhetit të përgjithshëm, komunave pritet t’u ndahen rreth 867 milionë euro.

Sfidat përpara

Një tjetër sfidë e konsiderueshme i pret shumë kryetarë menjëherë pasi të përfundojnë xixat e fushatës dhe ethet e ditës së zgjedhjeve: buxheti i pamiruar. Janë rreth 12 komuna që nuk e kanë miratuar buxhetin për vitin e ardhshëm - kryeqyteti në mesin e tyre - sipas afatit të përcaktuar me ligj, 30 shtator. Arsyet dallojnë: prej ndikimit të fushatës e deri te përçarjet e mëdha në kuvendet komunale. “Fakti që një komunë nuk e miraton buxhetin sipas afateve ligjore nënkupton që ajo komunë do të ketë më pak buxhet dhe, rrjedhimisht, më pak kapacitet për t’i implementuar projektet”, vlerëson Salihu. Komunat kanë afat deri më 1 mars të vitit të ardhshëm ta miratojnë buxhetin e bazuar në shumën e atij paraprake, në të

kundërtën kuvendi komunal i asaj komune shkon në zgjedhje.

Ku do të zhvillohen garat më të ashpra?

Salihu beson se mbi 20 komuna do të shkojnë në balotazh - që do të mbahet më 9 nëntor. Sipas tij, gara më e ashpër do të zhvillohet në Prishtinë, në Mitrovicë të Jugut, në Drenas, në Lipjan dhe në Podujevë. Për Ymerin, gara pa balotazh mund të përfundojë në Ferizaj, në Gjakovë, në Istog dhe, potencialisht, në Pejë. Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në këto zgjedhje kanë të drejtë vote 2 069 098 qytetarë. Rreth 44 000 prej tyre kanë të drejtë të votojnë me postë nga jashtë vendit në periudhën 17 shtator - 11 tetor. Kandidatët kanë shpenzuar mijëra euro për reklama, por të dielën shihet se kush e zgjodhi strategjinë më të mirë.

Ministria e Mbrojtjes pas pranimit të dronëve: Po forcohen kapacitetet goditëse të ushtrisë sonë



PRISHTINË, 10 TETOR - Ministria e Mbrojtjes ka falënderuar kompaninë “Baykar”, më saktë prodhuesin “Skydagger”, për dorëzimin në kohë rekord të dronëve të prokuruar nga Ministria e Mbrojtjes. “Kontrata me kompaninë ‘Baykar’, që është kompania

amë e prodhuesit ‘Skydagger’, u nënshkrua në nëntor të vitit të kaluar. Sipas planit fillestar, dronët duhej të mbërrinin në janar të vitit 2026, mirëpo, falë përkushtimit dhe profesionalizmit të kompanisë, dorëzimi u realizua tre muaj më herët.

Me këtë furnizim, Ministria e Mbrojtjes po vazhdon të rrisë dhe forcojë kapacitetet goditëse të ushtrisë sonë, në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe taktikat e luftës bashkëkohore. Faleminderit ‘Baykar’ dhe ‘Skydagger!’”, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.



TETË MUAJ PAS ZGJEDHJEVE, KONSTITUOHET KUVENDI I KOSOVËS

Gjashtë muaj pas seancës së parë konstituive, deputetët e legjislaturës së nëntë të premten e 10 tetorit kanë arritur ta konstituojnë Kuvendin e Kosovës. Pas zgjedhjes së nënkryetarit të pestë të Kuvendit të Kosovës, kryeparlamentari Dimal Basha e shpalli Kuvendin e Kosovës të konstituuar. Nenad Rashiq, nga partia Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, u zgjodh nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, pas dështimit të nëntë propozimeve të Listës Serbe

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 10 TETOR - Nenad Rashiq, nga partia Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, u zgjodh nënkryetar i Kuvendit të Kosovës pas dështimit të nëntë propozimeve të Listës Serbe dhe kalimit në zgjedhjen e nënkryetarit përmes procedurës së shortit. Me 71 vota për, 9 kundër dhe 24 abstenime, ai u bë një nga pesë nënkryetarët e Kuvendit të Kosovës. Përveç votave nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe disa prej deputetëve të komuniteteve joserbe, ai siguroi edhe votat e deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës dhe

ata të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës abstenuan, ndërsa Lista Serbe votoi kundër. Kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, e shpalli Kuvendin e Kosovës të konstituuar pasi Nenad Rashiq u zgjodh nënkryetar i Kuvendit nga pakica serbe. Rashiqi është nënkryetari i pestë i Kuvendit. Basha, gjithashtu, e shpalli të mbyllur seancën konstituive të Kuvendit të Kosovës. Kjo nënkupton se tani është hapur rruga edhe për formimin e qeverisë së re të vendit, shumë muaj pas zgjedhjeve të 9 shkurtit. Nenad Rashiq, nënkryetar i sapozgjedhur nga radhët e komunitetit serb, shkurtimisht falënderoi deputetët që votuan për zgjedhjen e tij. "Jam shumë falënderues ndaj kolegëve të mi të cilët sot kanë votuar për mua

dhe shpresoj që sot ky do të jetë një fillim i ri për ndërtimin e institucioneve sa më parë që të jetë e mundur", tha Rashiqi. Deputetja nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Hykmete Bajrami, tha se arsyetja pse deputetët e LDK-së votuan për Nenad Rashiqin nënkryetar të Kuvendit është aktgjykimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese. "Ne votuam për Nenad Rashiqin sot sepse aktgjykimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese ka dhënë një interpretim të cilin ne nuk e kishim paraparë dhe, sipas asaj që ne kemi kuptuar, ai ka të drejtë të zgjedhet nënkryetar nga komuniteti serb", tha Bajrami. Lista Serbe insistoi se të drejtë për t'u zgjedhur nënkryetar nga radhët e komunitetit serb kanë vetëm deputetët e Listës Serbe pasi që ata përfaqësojnë vullnetin e shumicës së komunitetit serb. E pyetur nëse do të ketë ndonjë koalicion për formim të qeverisë, Bajrami shprehu skepticizëm pasi që tha se nuk ka shumë kohë për një marrëveshje të tillë. "Nëse nuk formohet qeveria, votat e LDK-së do të jenë për shpërbërje të Kuvendit", tha Bajrami. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka

thënë se konstituimi i Kuvendit "duket se ende nuk e ka marrë përgjigjen e plotë", pavarësisht emërimit të nënkryetarit të pestë dhe të fundit. "Unë mendoj që ka pasur hapësirë tjetër për konstituim legal ose kushtetues, sepse kryetari i Kuvendit mendohej të konsultohet me ata që i japin udhëzime, në vend se të jepte interpretim. Ishte një konstatim se është bërë konstituimi, por si do të shkojë tutje mbetet të shihet", tha Krasniqi pas seancës. Partia e tij nuk votoi për Rashiqin, pasi zgjodhi të abstenojë, dhe Krasniqi u arsyetua se "qëndrimi ynë ka qenë gjithmonë i qartë, ne kemi vendosur për të gjithë njëjtë, sepse ndryshe i bie të biem në grackën e Albin Kurtit që i ndan serbët sipas lojaliteteve të tij". Krasniqi theksoi, gjithashtu, se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme "sa më parë". "Për ne është e rëndësishme që konstituimi të jetë final dhe të futemi në afate kushtetuese për formimin e qeverisë së re", tha ai. "Duke e ditur se asnjëra palë nuk e ka shumicën parlamentare, besoj se ajo që është më rëndësishme tani, është ta gjejmë mekanizmin që na dërgon në

zgjedhje të parakohshme sa më shpejt dhe pa vonesa. Shpresoj se do të ketë racionalitet mes palëve për të arritur pajtueshmëri për këtë", shtoi ai. Deputeti Igor Simiq nga Lista Serbe tha se, sipas kësaj partie, Kuvendi nuk është konstituuar as pas zgjedhjes së Nenad Rashiqit nënkryetar. "Edhe një herë u dëshmuar se drejtësia dhe e drejta nuk ekzistojnë. Sot nuk është përfunduar konstituimi i seancës së Kuvendit dhe mos lejon t'ju gënjejnë", tha ai, i shoqëruar në hollin e Kuvendit nga deputetët e tjerë të Listës Serbe. Ai citoi vendimin e Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit, siç lexoi ai, "fituesi i zgjedhjeve nga komuniteti serb duhet të ketë të drejtën ekskluzive për ta propozuar nënkryetarin e Kuvendit për komunitetin serb". "Është shkelur aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, edhe Kushtetuta dhe Rregullorja [e Punës së Kuvendit]", tha Simiq. Simiqi tha se Rashiqi "është zgjedhur me forcë si deputet, e tani edhe si nënkryetar". "E kanë zgjedhur një njeri pa thënë se ai ka dhënë dorëheqje nga posti i ministrit", tha Simiqi, duke shtuar se Lista Serbe do të ankohet ndaj këtij vendimi të Kuvendit. Kryetari i Nismës

OSMANI AKUZON SERBINË PËR NDËRHYRJE NË ZGJEDHJET LOKALE NË KOSOVË

PRISHTINË, 10 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e akuzoi Serbinë se po ndërhyr drejtpërdrejt në zgjedhjet lokale që do të mbahen në vend më 12 tetor. Osmani i bëri këto deklarata gjatë takimit që zhvilloi me kreun e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kreshnik Radoniqi. “Presidentja Osmani vuri theks të veçantë te ndërhyrjet e drejtpërdrejta që po bën Serbia në zgjedhjet lokale, një dukuri e përsëritur ndër vite, e cila po manifestohet përmes blerjes së votës, ndërhyrjeve të jashtme, frikësimit dhe dhunës”, u tha në njoftimin e Presidencës së Kosovës.

Osmani bëri thirrje për angazhim në mbrojtje të integritetit të procesit zgjedhor, duke “dënuar ashpër ndërhyrjet e Beogradit zyrtar”. “Ajo gjithashtu u bëri apel të gjithë aktorëve politikë dhe institucionalë, si dhe atyre ndërkombëtarë, që të kontribuojnë në mbrojtjen e votës së lirë dhe të dënojnë çdo akt të jashtëligjshëm që cenon vullnetin demokratik të qytetarëve të Kosovës”, u tha në njoftim.

Dy ditë më parë edhe kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, e akuzoi Serbinë se po ndërhyr në zgjedhjet e 12 tetorit përmes premtimeve për vende pune dhe përfitime financiare.

Kurti deklaroi se veprimet e fundit të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe të aktorëve të tjerë serbë, shtetërorë dhe joshetërorë, “nuk mund të cilësohen ndryshe përveçse ndërhyrje në procesin e zgjedhjeve lokale të tetorit në Kosovë”. “Premtimet për vende pune, joshja përmes përfitimit të mbështetjes financiare, kushtëzimi dhe shantazhi me beneficione sociale dhe deklarimet e



zyrtarëve shtetërorë të Serbisë, se vetëm Lista Serbe e mbron Serbinë në Kosovë, siç bëri së fundi ish-kryeministri i Serbisë, Millosh Vuçeviq, e siç ka bërë vetë presidenti Vuçiq, janë metoda të përsëritura të ndërhyrjes së Serbisë në Kosovë”, deklaroi ai.

Kurti kërkoi nga Bashkimi Evropian që ta sanksionojë Serbinë për këto veprime. Gjatë fundjavës Vuçiqi deklaroi për mediet serbe se “ne do t’i hapim 400 vende të reja pune në strukturën e kujdesit shëndetësor në Kosovë”. “Kjo është diçka shumë e madhe për

Kosovën dhe ne do ta bëjmë këtë brenda dhjetë ditëve të ardhshme, në mënyrë që njerëzit ta dinë se ne do të kujdesemi gjithmonë për të”, tha Vuçiqi. Vuçiqi, por edhe zyrtarë të tjerë në Serbi, po ashtu kanë bërë thirrje që serbët në Kosovë ta votojnë Listën Serbe - parti kryesore të serbëve që gëzon mbështetjen e Beogradit. Serbia u akuzua edhe për ndërhyrje në zgjedhjet e përgjithshme të shkurtit dhe misioni vëzhgues i BE-së tha asokohe se Serbia kishte ndërhyrë në zgjedhje përmes trysnisë ndaj votuesve serbë në

Kosovë.

Serbia u akuzua edhe nga Gjermania për ndërhyrje në zgjedhjet e 9 shkurtit në Kosovë. Në zgjedhjet e 12 tetorit, Lista Serbe pritet ta rimarrë pushtetin në komunat me shumicë serbe në Kosovë.

Në zgjedhje garojnë edhe katër parti të tjera serbe, por edhe disa iniciativa qytetare.

Katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës - Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku - udhëhiqen nga kryetarë shqiptarë, pasi në nëntor të vitit 2022 të gjithë përfaqësuesit e

Listës Serbe dhanë dorëheqje nga institucionet e Kosovës si reagim ndaj vendimit të autoriteteve të Kosovës për t’ua hequr targar serbe të makinave. Me kërkesën e Listës Serbe serbët në këto komuna bojkotuan zgjedhjet e prillit të vitit 2023 kur u zgjodhën kryetarët shqiptarë. Në vitin pasues serbët bojkotuan edhe votimin për shkarkimin e këtyre kryetarëve.

Serbia ndan të ardhura nga buxheti shtetëror për pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë. Këtu përfshihen paga, pensione, shtesa për fëmijë dhe ndihma të tjera financiare.

Socialdemokrate, Fatmir Limaj, e ka cilësuar “antikushtetuese” zgjedhjen e Nenad Rashiqit nënkryetar të Kuvendit të Kosovës nga pakica serbe. “Ajo çka pamë sot është, nëse e lexoni me kujdes aktgjykimin e Kushtetueses, shihet se kjo që ka ndodhur sot këtu është tërësisht antikushtetuese”, tha Limaj për “Klan Kosovën”. “Praktikisht ne po hyjnë në një fazë të shkëljes së vazhdueshme të Kushtetutës. Aktgjykimi i fundit e tregon qartësisht se të drejtën për propozuar e ka shumica serbe”, shtoi ai.

Albert Krasniqi nga organizata “Demokraci Plus” ka hedhur dyshime nëse mënyra se si u votua Nenad Rashiqi nënkryetar i Kuvendit të Kosovës nga pakica serbe është e ligjshme. “Kur përfundojnë tre raunde votimi për të gjithë kandidatët e propozuar nga shumica e deputetëve të

komunitetit serb, procedura rinis për ditët e mbetura brenda afatit 30-ditor për konstituimin e Kuvendit. Në këtë rast, shumica e deputetëve të komunitetit serb nuk e kanë refuzuar të drejtën për ta propozuar kandidatin, prandaj mekanizmi i ‘shortit’ nuk ka mundur të aktivizohet”, tha Krasniqi në “Facebook”.

Kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, thirri procedurën e shortit për propozimin e Rashiqit, pasi të gjithë kandidatët e Listës Serbe dështuan t’i merrnin votat e nevojshme dhe Igor Simiq nga kjo parti nuk e propozoi Rashiqin. “Ajo që ka ndodhur sot në praktikë është se kandidati për nënkryetar nuk është propozuar nga shumica e deputetëve të komunitetit serb, siç parashihet, por nga deputetët e shumicës”, shtoi Krasniqi, njohës i çështjeve politike dhe kushtetuese.

Çfarë tha Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin e 8 tetorit?

Në aktgjykimin e plotë, Gjykata ka thënë se, bazuar në Kushtetutë dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, nënkryetari i Kuvendit nga komuniteti serb zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, respektivisht 61 vota për, dhe propozimi bëhet me shkrim nga shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit serb. “Nga si më sipër, Gjykata nënvizon se propozimi për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, në rastin konkret, të komunitetit serb, duhet që të bëhet nga shumica apo numri më i madh i deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit serb”. Ky kriter, që kandidati të vijë nga shumica e përfaqësuesve të

komunitetit serb, është përmendur vetëm në nenet e aktgjykimit që flasin për procedurën gjatë propozimeve që bën Lista Serbe, por jo specifikisht edhe në nenet që flasin për fazën e shortit si mekanizëm zhbllokues.

Tani radha e formimit të qeverisë së re?

Tani që Kosova më në fund e ka një Kuvend të ri, me kryetar dhe nënkryetarë të zgjedhur, hapet rruga për hapin e radhës për formimin e institucioneve të reja, plot tetë muaj pas zgjedhjeve. Konstituimi i Kuvendit nënkupton se presidentja e vendit, siç i kërkohet me ligje, mund ta emërojë tani mandatarin për krijimin e qeverisë së re. Presidentja Osmani ka detyrë ligjore ta emërojë parti të koalicionin fitues - në këtë rast koalicionin e udhëhequr nga

Lëvizja Vetëvendosje, bashkë me Lëvizjen Guxo dhe Alternativën, mandatar për krijimin e qeverisë.

Kabineti i propozuar duhet të sigurojë të paktën 61 vota në Kuvendin me 120 deputetë për t’u miratuar. Me 48 ulëse të fituara në zgjedhjet e 9 shkurtit, Lëvizja Vetëvendosje nuk mund ta sigurojë shumicën e nevojshme pa një partner koalicioni. Në rast se nuk arrin t’i mbledhë 61 vota, presidentja Osmani ka detyrën brenda dhjetë ditësh t’i ftojë partitë për konsultime dhe të vendosë për mandatarin që ka shanset më të mëdha për ta formuar qeverinë. Mandatari do të ketë kohë 15 ditë për ta dorëzuar përbërjen e re të kabinetit qeveritar në Kuvend.

Nëse as pas përpjekjes së dytë qeveria nuk mund të formohet, presidentja Osmani, sipas Kushtetutës, duhet të shpallë zgjedhje të reja, që duhet të mbahen brenda 40 ditësh.

PRITJET DHE ËNDRRRAT E PARTIVE PËR 12 TETOR!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Ngricë rreth kutive të votimit: Interesimi i qytetarëve për të votuar në zgjedhjet lokale të 12 tetorit 2025 është jashtë pritjeve dhe parashikimeve. Sigurisht se sabotimi i pozitës në nivel qendror për formimin e institucioneve si dhe gjumi i thellë i opozitës kanë ndikuar që atmosfera para zgjedhjeve të ngjajë më shumë të një vizite për kryeshëndosh se përmbushje e detyrimit qytetar dhe ligjor për të votuar. Fushatat ishin monotone, pa gjallëri sepse po përtypen gjërat dhe premtimet që, as nuk janë realizuar e as që mund të realizohen. Po të mos ishte dyshi Mehmetaj - Lladrovci do ia krisnim gjumit këto net të ftohta dhe të mërzitshme. Do ta veçoja fushatën e Besa Shahinit dhe Natyra Kuçit, Arian Tahirit, Përparim Ramës dhe Uran Ismailit. Madje Urani, gjatë kësaj fushate, çdo të hëne e shpërndante një “gazetë” 4-faqëshe ku ishte oferta e tij dhe e PDK-së për qytetarët e kryeqytetit. Shukri Buja ishte shumë aktiv gjatë fushatës. Shaqir Totaj u zgjua nga kllapia e vapës së verës të tejngrohtë. Debatet televizive nuk i dëgjo fare, konsideroj se është humbje kohe; ose shikoj ndonjë dokumentar, ndonjë ndeshje futbolli ose lexoj diçka. E përçolla pjesërisht debatin e kandidatëve për Prishtinë. Hajnrullah Çeko nuk erdhi në Klan Kosova të “oligarkëve” shkaku i patriotizmit folklorik. Hajnrullahu është patriot për aq sa unë jam daja i Xhingis Kanit. Përrpa ishte mësuar ta dredhë e përdredhë fjalorin, nuk ishte ai i para katër vjetëve. Kishte më shumë siguri dhe me një arrogancë të menaxhuar mirë dominonte mbi butësinë argumentuese të Uranit dhe Besës. Përrpa po luan, tutti

per tutti, të gjitha në një kartë dhe, kam bindjen se ia del edhe për një mandat. Hajnrullahu i iku debatit kurse përkrahjen më rrënuese ia dha një fake profesor, llaskuc qeveritar, “prof.” dr. Ramçe. Qartë po duket se Hajnrullahu nuk po ka interesim të madh ta fitojë Prishtinën, nuk i përshtatet oksigjeni i kryeqytetit. Po as partia nuk është se i ka dhënë ndonjë të shtyme të fortë. Partia që në start e dëmtoi me sloganin zgjedhor: “Hajn (r) Prishtinës”. Alumni nderi i ardhshëm i Universitetit të Prishtinës, Mefail Bajcinovci do të kalonte më mirë, votuesit e LVV-së e kanë atë nivel. Urani ishte si Marathomaku, kurrë nuk u ndalë! Ta shohim çfarë lajmi do e dërgojë në parti, ra Sparta apo fitoi Sparta?!

Pritjet e partive: Pritjet i rrisin tej kaçikut votues që e kanë. Është normale të jesh optimist, për rrethana tona është jonormale të jesh realist! LVV-ja po deklaroi se fiton shumicën e komunave. Nëse e aktivizojnë linjën Kusari - Radoiqi, i kalojnë 10 komuna. PDK-ja e ka numrin magjik 10 komuna kurse LDK-ja konsideron 10 deri në 12 komuna. AAK-ja kënaqet me 5 komuna, kurse NISMA me kryeqytetin politik të saj - Malishevën. LS-ja pretendon 10 komuna e që ka gjasa edhe t'i fitojë. Sa komuna i ka vërtetë Kosova, po më dalin si shumë?! Ta mbajmë njëfarë rendi logjik dhe ashtu si mendoj se do të jenë rezultatet. LVV-ja - mund të llogarisë vetëm në ato komuna që i fiton pa balotazh, në komunat ku do të ketë balotazh ka gjasa të mëdha të mos e fitojë asnjë. PDK-ja i ka kërcyer vetes në bark

në Kaçanik dhe Drenas, në Dukagjin e ka humbur tokën elektorale kurse në Anamoravë ka dalë nga koma elektorale, vetëm sa për mbijetesë. Aktualisht vota më e fuqishme e PDK-së është rikthimi i respektit dhe dashurisë për UÇK-në. Më shumë vota iu sjellë Gjykata Speciale Raciste se puna që e kanë bërë me votues. LDK-ja, krahasuar me zgjedhjet e fundit besoj se mund të ketë rritje për dy komuna.

Fituesit e projektuar të komunave me shumicë shqiptare: Prishtina: Fitues shumë i mundshëm është Përparim Rama. Nëse shkon në balotazh me Uranin, do të djersitet kurse me Çekon e ka më lehtë. Në Mitrovicë do të fitojë, besoj shumë Arianit Tahiri. Pas balotazhit. Në Ferizaj fitues absolut është Agim Aliu. Besoj, pa balotazh. Në Pejë fiton Gazmend Muhaxheri, pas balotazhit. Në Prizren, nëse e ka përkrahjen e pakicave, fiton Shaqir Totaj. Në Gjakovë fitues është Ardian Gjini. Mund të ketë balotazh. Nëse LVV-ja nuk e fiton Gjilanin pa balotazh, në balotazh e humbë. Përcaktues për fituesin në balotazh do të jetë PDK-ja. Sokol Haliti, për një hap, pas balotazhit e fiton mandatin, besoj të fundit. Në Kamenicë do të ketë garë interesante, Qëndron Kastrati është sfidues serioz. Me përkrahjen e partive tjera mund edhe të rikthehet në krye të komunës. Në Han të Elezit PDK-ja fiton, mbase pa balotazh. Kaçaniku është problem më vete, PDK-ja i mprehë dhëmbët për fitore. A do t'i mpihen nga rrushi i thartë? Situatë me shumë të panjohura. Shtimja, për shkaqe

objektive dhe subjektive është shpallur kryeqytet i LVV-së. Besoj ashtu do të mbetet. Në Lipjan i japë përparësi Imri Ahmetit, para Shukri Bujës. Në Obiliq besoj se fiton, pa problem, Xhafer Gashi. Edhe në Fushë-Kosovë përparësi ka LDK-ja, me Besnik Osmanin. Në Vushtri kemi një situatë thuaja 50 për qind me 50 për qind. Dita e fundit e bënë diferencën midis PDK-së dhe LDK-së. Istogun e fiton LDK-ja, pa balotazh. Besoj se Klinën e fiton AAK-ja. Edhe në Rahovec fiton Smajl Latifi i AAK-së sikur edhe në Deçan. Junikun e fiton LDK-ja, besoj edhe Dragashin. Në Skenderaj, pa balotazh fiton PDK-ja. Në Drenas e kemi një personalitet karizmatik, Ramiz Lladrovci, thuaja pa parti dhe një person jokarizmatik, Petrit Hajdari, me parti të fuqishme. Balotazhi çon ujë në mullirin votues të Petrit Hajdarit. Lufta e Ramiz Lladrovci është si lufta e Davidit me Goliatin. Sipas mitologjisë, Davidi e mund Goliatin, por duket se realiteti do t'i rrëzojë mitet. Në Suharekë do të shkojnë rrumas AAK-ja dhe LDK-ja. E padefinuar deri në votat e fundit. Podujevën e lashë për fund sepse për LDK-në ka peshën e betejës së Stalingradit që përcaktoi fatin e luftës së dytë botërore. Shpejtim Bulliqi i LVV-së mendon se me këpucë të mandatit të kaluar, pa i dathë fare e siguron edhe një mandat. Nëse shkon në balotazh e pati puna e tij, LDK-ja e fiton mandatin. LVV-ja, më shumë do të varet nga marrëveshjet midis partive tjera pas balotazhit, se nga votat e votuesve të LVV-së. Rezultati i zgjedhjeve lokale do të përcaktojë edhe qeverinë e ardhshme. Mund edhe mos të ketë fare zgjedhje të reja

parlamentare. Mirëpo, edhe pesë ditë deri të dielën mund të provokojë ndryshime të paparashikueshme.

Kush e çliroi Kosovën: Pata menduar se krahu politik i UÇK-së ishte Bacë Adem Demaçi kurse krahu ushtarak ishte Komandanti Legjendar Adem Jashari. Në podkastin Pordhë dhe Pikë të projugosllavit legjendar Veton Surroi, mysafir ishte i “ikuri” nga Alkatrazi i Prishtinës, Xhafer Shatri. Nuk e dije se cili lavdërohej ose, më mirë me thënë, trillonte më shumë. A shkonin në ushtrime përgatitore për luftë në Shqipëri, a e përcaktonin politikën e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, me rëndësi pa ta nuk zhvillohej asnjë proces apo zhvillim global, politik dhe ushtarak. Kur i dëgjoje këta mysketjerë të rraskapitur nga angazhimi i madh, atëherë me të drejtë shtrohet pyetja, pse qenka dashur që Baca Adem Demaçi të vuajë 30 vite burgje dhe Komandanti Legjendar Adem Jashari të sakrifikohet kur paskan qenë aq të angazhuar ujditi Veton Surroi dhe marksistleninisti, Xhafer Shatri?! Pasi e bëri një pakt politik me Surroin, Shatrit i duhen edhe dy bashkëmendimtarë që ta kompletojnë trojkën ushtarake. Moti i ka zgjedhur, Mehmet Locin dhe Nazim Bllacën.

Liverpuli dhe Barcelona: Barcelona thuaja është bërë krejt si Liverpuli, 90 për qind. Për t'u bërë krejt Liverpul i duhet edhe një humbje, tre humbje radhazi! Si ngushëllim, Luverpuli i ka shpenzuar 550 milionë euro për blerje të lojtarëve kurse Barcelona e ka marrë Rashfordin veresi, deri në verë!

PROKURORIA KËRKON PARABURGIM PËR TË DYSHUARIN PËR SPIUNAZH, FATMIR SHEHOLLIN

PRISHTINË, 10 TETOR - Prokuroria Speciale e Kosovës i ka kërkuar Gjykatës Themelore në Prishtinë ta urdhërojë mbajtjen e Fatmir Shehollit në paraburgim derisa autoritetet po kryejnë hetime ndaj tij nën dyshimin se ka qenë i përfshirë në spiunazh kundër shtetit. Sheholli u arrestua të enjten në rrethin e Prishtinës pas hetimeve disamujore kundër tij. Ministri i Brendshëm në detyrë, Xhelal Sveçla, tha të enjten, pas arrestimit, se Sheholli ka pasur “hapësira të pakufizuara” në mediet e Kosovës dhe se ai ka “bashkëpunuar me aktorë që çdo ditë punojnë e veprojnë për ta minuar Republikën tonë dhe progresin e saj”. Prokuroria deri më tani nuk ka dhënë hollësi për atë se për kë dyshohet të ketë spiunuar Sheholli, por Sveçla la të kuptohet se ai mund të ketë spiunuar për Serbinë. “Mbesim

të përkushtuar të mbrojmë vendin tonë nga të gjitha qarqet që nuk hezitojnë ta rrezikojnë atë për çfarëdo përfitimi të tyre. Koha e spiunëve të Serbisë në Kosovë ka përfunduar. Kushdo që punon për Serbinë e kundër Kosovës do të ndiqet pa kompromis e pandalshëm”, shkroi Sveçla në “Facebook”. Policia e Kosovës kreu bastisje në vendbanimin e të dyshuarit të enjten. Së voni autoritetet në Kosovë kanë arrestuar, akuzuar e gjykuar serbë e shqiptarë nën dyshimet se po spiunonin për shërbimet e inteligjencës së Serbisë. Në qershor, gjykata në Prishtinë e dënoi Aleksandar Vllajiqin me pesë vjet burgim, pasi ai u deklarua fajtor për akuzat se ishte përfshirë në spiunazh si anëtar i Agjencisë serbe të Inteligjencës dhe

Sigurisë (BIA). Dy të dyshuar të tjerë, Bedri Shabani dhe Muharrem Qerimi, po gjykohen për spiunazh për Serbinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ata janë deklaruar të pafajshëm për akuzat se kishin dhënë informacione të BIA serbe për disa institucione të sigurisë në Kosovë, për UÇK-në dhe masakrën e Reçakut. Në një rast tjetër po gjykohet edhe serbja Jellena Gjukanoviqit, e cila akuzohet për spiunazh për inteligjencën serbe. Ajo e ka mohuar fajësinë. Në Kosovë spiunazhi përkufizohet si aktivitetet sekret i mbledhjes, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit të ndjeshëm në një shtet, organizatë ose grup tjetër. Sipas Kodit Penal të Kosovës, spiunazhi konsiderohet krim i rëndë dhe dënohet me të paktën pesë vjet burgim, nëse i dyshuari shpallet fajtor.



Ekspertët kanë thënë se spiunazhi është kërcënim serioz për sigurinë e Kosovës dhe arrestimet e fundit vetëm sa nxjerrin në pah rrezikun e vazhdueshëm. Sipas tyre, ky aktivitet jo vetëm që destabilizon vendin brendapërbrenda, por

dëmton edhe pozitën e tij ndërkombëtare. Ish-kryeinspektori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI), Burim Ramadani, e konsideron spiunazhin një prej kërcënimeve kryesore të sigurisë kombëtare në vend.

MILIONA PËR STUDENTËT, PACIENTËT PRESIN NË SPITALE PA PAJISJE DHE STAF

PRISHTINË, 10 TETOR - Ndërsa Qeveria në detyrë e Kosovës ndan miliona euro për studentë para zgjedhjeve, spitalet rajonale përballen me mungesë shtretërish, aparaturash dhe stafi mjekësor. Qindra mjekë largohen nga Kosova çdo vit, duke shkaktuar pritje deri në tre vjet për shërbime në QKUK. Investimet në spitale nuk janë të dukshme në shumicën e hapësirave dhe shërbime të rëndësishme si kimioterapia ofrohen vetëm në Prishtinë. Në spitalin rajonal të Ferizajt shtretërit janë plot dhe pacientët presin radhën për një ekzaminim që shpesh nuk mund të bëhet aty. Rreth 35 kilometra larg, në Prishtinë, qeveria në detyrë u ndan 26 milionë euro ndihmë studentëve - vetëm pesë ditë para zgjedhjeve lokale. Për disa kjo ndihmë mund të jetë e mirëpritur, për kritikët është dëshmi se shteti shpërndan para aty ku ka më shumë vota, e jo aty ku nevojat janë më urgjente. “Vërtet nuk është e kuptueshme që një qeveri, në prag të zgjedhjeve, të shpërndajë mjete pa bërë një analizë apo llogaritje të saktë të ndikimit të tyre”, thotë për Radion Evropa e Lirë, Blendi Hasaj, drejtor ekzekutiv i Institutit për Hulumtime të Avancuara GAP në Prishtinë. Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj është një prej shtatë spitaleve rajonale të Kosovës të cilat funksionojnë nën ombrellën e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK). Në nëntor të vitit të kaluar ekipi i REL-it vizitoi këtë spital dhe pa një realitet të zymtë: rrëmujë, papastërti, pajisje të prishura



dhe mure të mbuluara nga lagështia. Izolimi i mureve ose zëvendësimi i orendive, si lavamanët pa rubinete, kërkon disa mijëra euro. Megjithatë, gjendja vazhdon të jetë thuajse e pandryshuar edhe pas një viti. Drejtori Fikret Arifi thotë se situatën e përkeqëson edhe mungesa e hapësirave në disa reparte. “Në repartin e internës i kemi 15 shtretër dhe janë plot, nuk mund të pranojmë raste të reja”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Me mungesë të kapaciteteve të ngjashme thotë se përballet edhe Reparti i Pediatrisë, ndërsa spitali nuk ka fare hematologë dhe numri i radiologëve është i kufizuar. “Si pasojë e mungesës së këtyre shërbimeve, pacientët duhet të referohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës [QKUK] në Prishtinë”, thotë Arifi. Në këtë qendër referohen edhe pacientë që adresë do të duhej ta

kishin Spitalin e Përgjithshëm të Mitrovicës. Ky spital nuk ka rezonancë magnetike, thotë drejtori i tij, Gëzim Berisha, për Radion Evropa e Lirë. Pajisja me një të tillë “do ta shkarkonte shumë edhe Qendrën Klinike Universitare të Kosovës”, thotë ai. Rezonanca magnetike shërben për t'i parë strukturat e brendshme të trupit në detaje. Çmimet e saj në uebfaqe të ndryshme në internet sillen nga disa qindra mijëra euro deri në mbi një milion. Berisha thotë se spitali në Mitrovicë përballet edhe me mungesë stafi. “Për shembull, kur një pacient përfshihet në një aksident rrugor dhe ka nevojë për konsultën e një kirurgu torakal, ne duhet ta referojmë në Prishtinë, sepse nuk kemi mjek torakal”, thotë ai. Problemet me mungesë stafi, barnash apo aparaturash nuk

janë të kufizuara vetëm në këto dy spitale - ato prekin të gjitha institucionet shëndetësore në Kosovë. Vitin e kaluar mbi 100 mjekë e braktisën vendin, duke u ankuar për kushtet e punës dhe pagat e ulëta. Në 2023-n ky numër arriti në 167, ndërsa në periudhën 2018-2022, sipas Odës së Mjekëve të Kosovës, u larguan mbi 650 mjekë. Për pasojë, pritjet për shërbime të caktuara në QKUK zgjasin me muaj apo dhe vite. Zyra e Auditorit Kombëtar raportoi vitin e kaluar se pritja mesatare e pacientëve në këtë institucion arrinte në gati tre vjet. Pavarësisht prej ndërrimit të qeverive dhe premtimeve për reforma, qoftë nga ShSKUK-ja apo Ministria e Shëndetësisë, problemet e tilla e kanë përcjellë sektorin e shëndetësisë që nga paslufta më 1999.

Investimet nuk kanë munguar. Për shembull, vitin e kaluar janë përruar renovimet e Klinikës së Kardiologjisë në QKUK, por në shumë hapësira ato nuk janë të dukshme. Për kimioterapiën që përdorin pacientët e sëmurë me kancer, ata duhet të drejtohen vetëm në QKUK, se në asnjë spital tjetër të Kosovës ajo nuk ofrohet. Dhe, në QKUK, ka pasur raste kur mbingarkesa i ka detyruar ata të marrin kimioterapi në salla të improvizuara. Hasaj thotë se ndarja e miliona eurove nga qeveria nuk duhet të ketë vetëm efekt afatshkurtër, por të sjellë ndryshim të qëndrueshëm, pavarësisht sektorit se ku shfrytëzohen. “Për shembull, të mbulohet shpenzimi për pushimin e lehonisë, jo nga sektori privat apo nga punëdhënësit, por të bëhet përgjegjësi e qeverisë. Sepse, sipas meje, kjo do të kishte efekt të dukshëm, do të ndikonte në ndryshimin e qasjes dhe strukturës së punësimit”, thotë Hasaj. Sipas vendimit të qeverisë në detyrë, të datës 7 tetor, 20 milionë euro janë ndarë për mbështetjen e studentëve bazuar në distancën që e kanë nga vendi i banimit tek ai ku studiojnë. E gjashtë milionë euro të tjera janë ndarë për një shtesë prej 100 eurosh për të gjithë studentët me rastin e fillimit të vitit të ri akademik. Partitë ish-opozitare e kanë cilësuar këtë vendim si “blerje votash” në prag të zgjedhjeve lokale të 12 tetorit, por jo edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti. “Ata [studentët] dhe familjet e tyre do ta kenë më lehtë përballimin e kostove”, tha ai.

Hapet aplikimi për mbështetjen e studentëve me nga 100 euro

PRISHTINË, 10 TETOR - Aplikimi për mbështetjen e studentëve tashmë është i hapur në eKosova, te shërbimi Familja për shtesën e njëhershme 100 euro. Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar se të drejtë aplikimi kanë studentët aktivë të të gjitha niveleve (bachelor, master, doktoratë) që studiojnë në ndonjërin nga universitetet e akredituara në Kosovë, publike dhe private. “Sigurohuni që i

plotësoni të gjitha fushat saktë dhe pa gabime. Nëse ka gabime, aplikimi refuzohet. Afati për aplikim është deri në fund të muajit tetor, kurse pagesat do të kryhet me grupe, sipas radhës së aplikimit”, ka shkruar Murati në “Facebook”. Murati edhe për Bursën e Mobilitetit të Studentëve ka dhënë hollësi. “Të drejtë aplikimi kanë studentët e nivelit Bachelor, shtetas të Kosovës, që studiojnë në ndonjërin nga universitetet e

akredituara në Kosovë. Kusht për përfitimin e Bursës së Mobilitetit është që familja e studentit/studentes të ketë të ardhura vjetore bruto jo më shumë se 12 000 euro. Sigurohuni që i plotësoni të gjitha fushat saktë dhe pa gabime. Nëse ka gabime, aplikimi refuzohet”, shkruan ai. Dy ditë më parë qeveria në detyrë mori vendim që shuma e përgjithshme për përkrahjen e studentëve është raportuar të jetë 26 milionë euro.



KOSOVA NDALON PËRKOHËSISHT IMPORTIN E KAFSHËVE TË GJALLA NGA MALI I ZI PËR SHKAK TË SHPËRTHIMIT TË “GJUHËS SË KALTËR”

PRISHTINË, 10 TETOR - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Republikës së Kosovës (AUV) ka njoftuar për vendosjen e një mase të përkohshme ndalese për importin e kafshëve të gjalla nga Mali i Zi pas konfirmimit të rasteve me sëmundjen virale “Gjuha e Kaltër” (Bluetongue - BT). Sipas AUV-it, ndalesa përfshin gjedhët, delet dhe dhitë, dhe vlen për të gjithë territorin e Malit të Zi. Kjo masë është ndërmarrë si veprim parandalues ndaj përhapjes së sëmundjes në territorin e Kosovës, në përputhje me njoftimet

ndërkombëtare nga sistemet ADIS dhe WAHIS. “Autoritetet kufitare që veprojnë në kuadër të Menaxhimit të Integruar të Kufirit - Policia e Kosovës, Doganat dhe AUV - obligohen të zbatojnë masa të shtuara kontrolli në të gjitha pikat kufitare, për të parandaluar hyrjen në vend të kafshëve të gjalla të përmendura nga ky shtet”, thuhet në njoftim. Çfarë është sëmundja “Gjuha e Kaltër”? “Gjuha e Kaltër” është një sëmundje virale që transmetohet nga insektet e llojit Culicoides (mushkonja),

e cila prek ruminantët shtëpiakë si gjedhët, delet dhe dhitë. Delet janë më të ndjeshme ndaj infeksionit, ndërsa gjedhët shërbejnë si bartës të virusit pa shfaqur gjithmonë simptoma të rënda. Sëmundja nuk transmetohet te njerëzit dhe nuk paraqet rrezik për shëndetin publik. Autoritetet kanë bërë thirrje për bashkëpunim të ngushtë në mes të gjitha institucioneve përkatëse për t'i zbatuar masat e nevojshme mbrojtëse dhe për të parandaluar çdo rrezik potencial ndaj sektorit të blegtorisë në Kosovë.



ATK-ja, TAKIM ME PARTNERËT INSTITUCIONALË DHE PËRFAQËSUESIT E KOMUNITETIT TË BIZNESEVE

PRISHTINË, 10 TETOR - Administrata Tatimore e Kosovës, e udhëhequr nga drejtori i përgjithshëm Mentor Hyseni, bashkë me dy zëvendës drejtorët e përgjithshëm Isen Lipovica dhe Sami Salihu, ka mbajtur takim me palët e interesit, përfshirë institucionet shtetërore, komunitetin e bizneseve si dhe organizatat profesionale për kontabilitet dhe auditim. Takimi është organizuar me qëllim të forcimit të bashkëpunimit dhe nxitjes së veprimit konkret për edukimin tatimor dhe zhvillimin profesional. Hyseni theksoi se qëllimi është që koordinimet formale të shndërrohen në bashkëveprim



të mirëfilltë dhe ndikim konkret, duke ndërtuar ura të qëndrueshme bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat, në mënyrë që

administrimi tatimor të perceptohet si partneritet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Drejtori i përgjithshëm nënvizoi

se ATK-ja do të fokusohet më shumë në edukimin e tatimpaguesve, me qëllim që të kemi më pak ndëshkime, sepse një qytetar apo biznes i

mirinformuar është kontribuuesi më i mirë i tatimeve, sidomos kur kupton se këto mjete kthehen në interes të publikut përmes një rishpërndarjeje të drejtë dhe të barabartë. Në këtë kuadër, ATK dhe partnerët e saj do të punojnë bashkërisht për edukimin e të rinjve si brez i ardhshëm dhe me ndikim pozitiv në tregun tatimor si dhe në periudhat e rekrutimit të stafit të ri profesional. Përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave të pranishme vlerësuan gatishmërinë e ATK-së për bashkëpunim dhe partneritet, duke theksuar se bashkëpunimi i rregullt dhe shkëmbimi i informacionit janë thelbësorë për luftimin e evazionit fiskal dhe për zhvillimin e një tregu më të drejtë dhe konkurrues.

Policia dhe ATK-ja merren vesh për bashkëpunim

PRISHTINË, 10 TETOR - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, ka takuar të premtën udhëheqësin e Administratës Tatimore të Kosovës, Mentor Hyseni. Takimi ishte i një karakteri

njoftues dhe bashkëpunues në mes të dy institucioneve në funksion të ndërveprimit institucional në fusha të ndryshme që do të ndikonte pozitivisht në kryerjen e detyrave të të dy institucioneve.

Drejtori i përgjithshëm i PK-së ka falënderuar përfaqësuesin e ATK-së, njëherësh të dyja palët shprehën gatishmëri për forcimin e marrëdhënieve të përbashkëta në shërbim të qytetarëve.



INTERVISTA E NOVELISTES PËR PAQEN, MARÍA CORINA MACHADO: EVROPA MUND TË KISHTE BËRË SHUMË MË TEPËR PËR VENEZUELËN



Nga Sara GANDOLFI,
Corriere della Sera

Udhëheqësja e opozitës, e ndjekur nga një urdhër arresti për "terrorizëm", ka jetuar e fshehur për muaj të tërë. "Nuk i kam parë fëmijët e mi për një vit e gjysmë."

Ajo denoncon "zgjedhjet e rreme" të diktaturës. Ajo falënderon "shoqen" e saj Giorgia Meloni dhe argjentinasi Javier Milei "për mbështetjen e tyre për popullin venezuelian". Ajo është "thellësisht mirënjohëse ndaj Trump për masat e marra kundër regjimit të Nicolás Maduro". Por ajo është e zhgënjyer nga Evropa, "mund të kishte bërë shumë më tepër", dhe nga bashkësia ndërkombëtare, e cila "preferon të heshtë". María Corina Machado është një grua që nuk dorëzohet. Ajo lufton. Shumë udhëheqës të tjerë të opozitës kanë zgjedhur mërgimin. Ajo qëndroi, e fshehur dhe një burrë i kërkuar. A dëshiron të jetë një simbol dhe martir i demokracisë? Ajo pranon, me zë të thyer, se nuk i ka parë fëmijët e saj për një vit e gjysmë. Pastaj, megjithatë, ajo tund kokën nga vendi ku fshihej: "Unë do të jem presidente."

Qeveria thotë se do ta arrestojnë herët a vonë... Pse nuk e kanë bërë ende?

"Nuk e dinë se ku jam."

Për çfarë po e akuzojnë?

"Terrorizëm, si të gjithë njerëzit e përfshirë në fitoren tonë të jashtëzakonshme presidenciale më 28 korrik, kur arritëm të mposhtnim tiraninë e korruptuar dhe kriminale dhe ta demonstionim atë para botës. Më 28 korrik, ne fituam. Bota e ka njohur Edmundo Gonzalez (kandidati i opozitës) si president i Venezuelës, ashtu si Italia, Shtetet e Bashkuara, Argjentina, Panamaja dhe shumë vende të tjera. Maduro është fajtor për terrorizëm shtetëror. Ka mbi 950 të burgosur politikë në Venezuelë, përfshirë adoleshentë, gra dhe dëshmitarë të zgjedhjeve të manipuluar, të kapur thjesht për mbrojtjen e të drejtës për një votë të drejtë. Shumë u torturuan, shumë u zhdukën."

Si ndodhi kjo në epoka të tjera në Argjentinë ose Kili?

"Shumë më keq, sepse këtu ndodhi në një periudhë shumë më të shkurtër kohore. Menjëherë pas fitores presidenciale, regjimi filloi të persekutonte dhe arrestonte

kundërshtarët, duke eliminuar të gjitha format e lirisë së shprehjes. Ishte brutale; të gjitha maskat ranë. Ata nuk interesohen më se çfarë mendon pjesa tjetër e botës." Gjithashtu në një burg të Venezuelës është italiانى Alberto Trentini, i akuzuar për komplot...

"E kam dëgjuar emrin e tij, por nuk e di historinë e tij. Megjithatë, mund të them se Maduro i ka përdorur të burgosurit si mjet për shantazh për shumë vite. Njerëzit arrestohen edhe nëse nuk kanë kryer ndonjë krim. Në këmbim të lirim të tyre, regjimi kërkon që vendet e tyre përkatëse të mos i denoncojnë tmerret që ndodhin në Venezuelë. Kështu ka funksionuar deri më tani, por për fat të mirë po filloj të shoh një përgjigje të ndryshme nga disa vende që nuk pranojnë më shantazh për të siguruar lirinë e qytetarëve të tyre që ishin në Venezuelë vetëm për biznes ose turizëm. Ka më shumë se tridhjetë të burgosur politikë të huaj.

Vitet kalojnë, por Maduro mbetet në pallatin presidencial në Miraflores...

"Sepse ai është një kriminel, jo një diktator konvencional. Mbi 9 milionë venezuelianë,

pothuajse një e treta e popullsisë, janë detyruar qëllimisht nga regjimi të largohen nga vendi. Maduro dëshiron të destabilizojë rajonin dhe e ka shndërruar Venezuelën në një strehë për kartelet e drogës, guerilasit, spiunët rusë dhe grupet terroriste si Hezbollahu dhe Hamasi."

Pse do ta bënte këtë?

"Të qëndrojnë në pushtet, me çdo kusht, dhe të plaçkitë burimet e mëdha të Venezuelës, e cila zotëron rezervat më të mëdha të naftës në botë, rezervat e teta më të mëdha të gazit natyror dhe rezervat e pesta më të mëdha të arit... Por populli venezuelian është heroik. Pavarësisht zgjedhjeve të rreme, persekutimit dhe terrorit, shoqëria është organizuar për të pohuar të drejtën tonë për liri."

Megjithatë, njerëzit kanë frikë të demonstrojnë sot...


"Por regjimi nuk ka qenë kurrë kaq i dobët. Maduro është plotësisht i izoluar ndërkombëtarisht, madje edhe nga aleatët historikë si Rusia, Irani, Siria dhe Kina. Dhe javën e kaluar, Presidenti Trump ndaloi operacionet e kompanive

perëndimore të naftës në Venezuelë, gjë që i lejoi regjimit të mblidhte sasi të mëdha parash, të cilat më pas u përdorën për fushata terroriste. Kjo po krijon tensione shumë të forta brenda komandës së lartë ushtarake, e cila është "mbështetja" e fundit e mbetur e Maduros. Represioni mbështetet nga pandëshkueshmëria dhe paratë. Kjo është arsyeja pse kërkoj që ata që kanë kryer krime kundër njerëzimit të gjykohen nga Gjykata Ndërkombëtare Penale dhe nga vendet me juridiksion ndërkombëtar. Evropa duhet të publikojë emrat e atyre që janë përfshirë në represion, sepse i njeh ata! Dhe duhet të sanksionojë shkelësit e të drejtave të njeriut. Pjesa më e madhe e parave që merr Maduro kalon përmes sistemeve financiare të vendeve evropiane. Ju duhet ta kuptoni. Se problemi i Venezuelës i tejkalon kufijtë tanë, sepse drogat që arrijnë në Evropë kalojnë nga këtu."

Dhe kur të bëhet president, çfarë do t'i ndodhë Maduros?

"Varet prej tij. Nëse vendos apo jo të bashkëpunojë në një proces tranzicioni të rregullt dhe të negociuar. Kjo është ajo që i kemi ofruar."

LÁSZLÓ KRASZNAHORKAI, FITUES I NOBELIT PËR LETËRSI MË 2025



Nga: The GUARDIAN

Shkrimtari hungarez, László Krasznahorkai, është shpallur fitues i Nobelit për Letërsi, “për veprën e tij mbresëlënëse dhe vizionare që, në mes të një tmerri apokaliptik, riafirmon fuqinë e artit”.

“László Krasznahorkai është shkrimtar i madh epik në traditën e Evropës Qendrore, që shtrihet nga Kafka te Thomas Bernhard dhe karakterizohet nga absurdi dhe eksesi grotesk”, ka thënë Anders Olsson, kryetar i Komitetit të Nobelit.

I lindur në Xhula të Hungarisë, në vitin 1954, Krasznahorkai u bë i njohur për herë të parë me romanin e tij të parë Tangoja e djallit [Sátántangó], në vitin 1985 - një portretim i zymtë dhe magjepsës i një komuniteti rural në shkatërrim e sipër [Njerëz që besojnë se ishin të vdekur, shfaqen në skenë dhe konsiderohen nga të gjithë të pranishmit si lajmëtarë të shpresës ose të fundit të botës, ndërsa elementët djallëzorë fshihen në faktin se të ardhurit manipulojnë banorët që shpresojnë shpëtimin]. Romani fitoi çmimin e librit më të mirë të përkthyer në anglisht [Best Translated Book], pothuajse tri dekada më vonë, në vitin 2013.

Shpesh i përshkruar si postmodern, Krasznahorkai njihet për fjalitë e tij të gjata e të ndërlikuara, temat distopike dhe melankolike, dhe për një intensitet të pandërprerë që ka bërë që kritikët ta krahasojnë me Gogolin, Melvillein dhe Kafkan. Tangoja e djallit u adaptua në një film

shtatorësh nga regjisor i Béla Tarr, me të cilin Krasznahorkai ka pasur një bashkëpunim të gjatë krijues. Karriera e Krasznahorkait është formësuar po aq nga udhëtimet sa edhe nga gjuha. Ai e la për herë të parë Hungarinë komuniste në vitin 1987, duke kaluar një vit në Berlinin Perëndimor me një bursë studimi, dhe më pas gjeti frymëzim në Azinë Lindore - veçanërisht në Mongoli dhe Kinë - për vepra të tilla si I burgosur i Urgës [The Prisoner of Urga] dhe Shkatërrimi dhe trishtimi nën qiej [Destruction and Sorrow Beneath the Heavens]. Por, ai ka shkruar gjithashtu një sërë veprash të frymëzuara nga përshtypjet e thella që i kanë lënë udhëtimet e tij në Kinë dhe Japoni, si romani i tij i vitit 2003 Një mal në Veri, një liqen në Jug, një shteg në Perëndim, një lumë në Lindje [Északról hegy, Délről tó, Nyugatról utak, Keletről folyó], botuar në anglisht në vitin 2022) - një rrëfim misterioz me pjesë të fuqishme lirike që zhvillohet në juglindje të Kjosos. Gjatë punës për romanin Lufta dhe lufta [War and War], ai udhëtoi gjerësisht në Evropë dhe jetoi për një kohë në apartamentin e Allen Ginsbergut në Nju-Jork, duke e përshkruar mbështetjen e poetit legjendar të bit-poezisë si thelbësore për përfundimin e romanit.

Adhuruesit e tij janë të shquar: Susan Sontag e quajti “mjeshtri bashkëkohor hungarez i apokalipsit”, ndërsa WG Sebald vlerësoi universalitetin e vizionit të tij.

Megjithëse ka shtëpi në Hungari, Krasznahorkai ka kaluar vitet e fundit duke jetuar në mërgim të

vetëshpallur në Berlin dhe Trieste, dhe nuk e ka fshehur përbuzjen e tij për politikën e kryeministrit Viktor Orbán.

Në romanin e tij Baroni Venkhajm kthehet në shtëpi [Baron Wenckheim's Homecoming], botuar në anglisht në vitin 2019, shfaqet një figurë “e ligë, e sëmurë dhe e gjithëpushtetshme”, pa emër, që kalon nëpër qytet me një autokolonë të zezë dhe që disa kritikë e kanë identifikuar si një simbol për kryeministrin autoritar i cili ka qeverisur Hungarinë që nga viti 2010.

Gjatë kohës në pushtet, partia Fidesz e Orbánit ka nënshtuar sistematikisht universitetet, teatrot, mediat e pavarura dhe industrinë e botimeve sipas modelit të saj të “demokracisë jolibérale”. Lidhur me luftën në Ukrainën fqinje, Hungaria është përpjekur të ndjekë një qëndrim neutral, duke e dënuar luftën, por gjithashtu duke fajësuar Ukrainën dhe aleatët e saj perëndimorë, ndërkohë që mbetet një nga të paktat vende evropiane që nuk ka dhënë ndihmë ushtarake. Në një intervistë për Yale Review në shkurt të këtij viti, Krasznahorkai e përshkroi dështimin e Orbánit për të dënuar Putinin si rezultat i një “mentaliteti psikiatrik”. “Hungaria është vend fqinj i Ukrainës, dhe regjimi i Orbánit po mban një qëndrim të paprecedentë - pothuajse të pashembullt në historinë hungareze”, tha ai. “Kurrë nuk do ta kisha imagjinuar që udhëheqja politike hungareze do të fliste për një të ashtuquajtur neutralitet në këtë çështje! Si mund të jetë një vend neutral kur rusët pushtojnë një vend fqinj”?!

Në vitin 2015, Krasznahorkai u bë shkrimtari i parë hungarez që fitoi Çmimin Ndërkombëtar “Man Booker”.


Në një intervistë për Guardian në vitin 2012, Krasznahorkai tha se nuk donte kurrë të bëhej shkrimtar sepse nuk mund ta imagjinonte veten në rrethet letrare. “Jo sepse nuk mund të admiroja shkrimtarët në Hungari apo në letërsinë botërore. Isha adhurues i madh i personaliteteve më të mëdha të letërsisë botërore - kjo është normale - por, nuk mund ta imagjinoja veten në atë rreth”.

Pasi lexoi në moshën 18-vjeçare sonetin e Rainer Maria Rilkes, Trupi arkaik i Apolonit [Archaischer Torso Apollos], ai u trondit nga mesazhi urgjent i vargut të fundit, “Duhet ta ndryshosh jetën tënde”, dhe vendosi të zbriste “në katin e poshtëm të shoqërisë, në bodrum”. Një seri punësh të përkohshme e çuan përfundimisht në një fermë, ku punoi si rojë nate. Një mëngjes, pas një nate në stallën e lopëve, ai shkoi të flinte, “dhe njerëzit aty më thanë: “Të lutem mos fli, sepse po vjen dikush për të kastruar derrkucët”. E pritëm këtë njeri - ai ishte krejtësisht i panjohur për mua - kishte një atmosferë shumë të rëndë rreth tij, lajmet për të ishin shumë të këqija, por askush nuk ishte tamam i sigurt pse. Ai mbërriti. Ishte i gjatë, kishte një hundë të madhe, ishte pothuajse pa fjalë, dhe kishte veshur një pallto shumë të gjatë. Njerëzit aty e ftuan për një gotë pàlinka - ishte e detyrueshme kjo atje - dhe pas kësaj, ky njeri i gjatë

u ul dhe ne duhej të mbanim derrkucët. Ishte aq e tmerrshme dhe derrkucët vuajtën shumë, ulërinin dhe përpëliteshin, dhe unë duhej t'i shtypja poshtë. Njeriu ishte krejtësisht pa ndjeshmëri, pa shpirt, pa emocion, dhe ai i preu dhe u bë gati për të tjerët! Ky makth me sy hapur ishte burimi i Tangos së djallit - jo kjo skenë, por atmosfera e saj, thelbi i saj: “Atëherë mendova: duhet të shkruaj diçka për botën, jo për Hungarinë komuniste, jo për Hungarinë, jo për këtë peizazh me njerëz shumë të varfër dhe rrethana të mjerueshme, por për botën në një nivel më të thellë”.

I pyetur se si do ta përshkruante veprën e tij, në një intervistë për Guardian ai u përgjigj: “Shkronja; pastaj nga shkronjat, fjalë; pastaj nga këto fjalë, disa fjalë të shkurtra; pastaj më shumë fjalë, më të gjata, dhe në thelb fjalë shumë të gjata, për një periudhë prej 35 vjetësh. Bukuri në gjuhë. Argëtim në ferr”. Ndërsa, për lexuesit që zbulojnë veprën e tij për herë të parë, ai shtoi: “Nëse ka lexues që nuk i kanë lexuar librat e mi, nuk do t'u rekomandoja asgjë për të lexuar; përkundrazi, do t'i këshilloja të dalin jashtë, të ulen diku, ndoshta pranë një përroi, pa bërë asgjë, pa menduar për asgjë, thjesht të qëndrojnë në heshtje si gurë. Do të takojnë eventualisht dikë që i ka lexuar librat e mi”.

Çmimi Nobel për Letërsi është dhënë 117 herë, që nga viti 1901. Krasznahorkai do ta marrë zyrtarisht medaljen dhe diplomën në një ceremoni që do të mbahet në një dhjetor në Stokholm. /Telegrafi/



Arabia Saudite, nikoqire e Kupës së Botës 2034

RIAD, 10 TETOR - FIFA ka konfirmuar se Arabia Saudite do të jetë nikoqire e Kupës së Botës 2034, duke sjellë për herë të parë turneun më të madh futbollistik në historinë e saj. Vendi arab u shpall fitues i kandidaturës pa konkurrencë direkte, pasi

Australia është tërhequr në momentet e fundit. Ky Botëror do të zhvillohet me 48 kombëtare pjesëmarrëse dhe pritet të luhet në 15 stadione moderne në pesë qytete kryesore: Riyadh, Jeddah, Al Khobar, Abha dhe projekti futuristik NEOM.

Stadiumi "King Salman" në kryeqytet, me kapacitet rreth 92 mijë vende, do të jetë arena e finales dhe e ndeshjes hapëse. Autoritetet saudite kanë nisur investime gjigante në infrastrukturë, përfshirë stadione të reja dhe transport publik, ndërsa kanë

konfirmuar se gjatë turneut nuk do të shitet alkool, në përputhje me rregullat lokale. Kupa e Botës 2034 shihet si një hap i madh në vizionin "Saudi Vision 2030", me synim të paraqitet Arabia Saudite si një qendër globale sportive dhe turistike.



20 KOMBËTARET QË E KANË SIGURUAR TASHMË KUPËN E BOTËS



ORAN, 10 TETOR - Futbollistët algerianë i përkasin kombëtares së 20 që kualifikohet për Kupën e Botës e cila do të zhvillohet në ShBA, Meksikë dhe Kanada nga 11 qershori deri më 19 korrik 2026. Algjeria ka siguruar vendin e parë në Grupin G të Zonës Kualifikuese Afrikane me një fitore të thellë 3-0 ndaj Somalisë në raundin e parafundit. Edhe pse Somalia ishte formalitet pritëse, ndeshja është zhvilluar në Oran në tokën algeriane. Pas nëntë raundeve, Algjeria ka grumbulluar 22 pikë, duke bërë të pamundur që Uganda, e cila ka 18 pikë, të kapë vendin e parë. Kjo do të jetë paraqitja e pestë e Algjerisë në histori në Kupën e Botës pas viteve 1982, 1986, 2010 dhe 2014.

Algjeria është skuadra e katërt

afrikane që siguron kualifikimin për Botërorin 2026, duke iu bashkuar Marokut, Tunizisë dhe Egjiptit, rivalët e saj të Afrikës së Veriut.

Kupa e Botës 2026 do të presë edhe ekipet pritëse Kanada, Meksikë dhe ShBA, si dhe Japoninë, Zelandën e Re, Iranin, Uzbekistanin, Korenë e Jugut, Jordaninë dhe Australinë. Nga Amerika e Jugut, përveç Argentinës, kampionia aktuale e botës, kualifikimin e kanë siguruar edhe Ekuadori, Brazili, Uruguai, Paraguai dhe Kolumbia. Ky kualifikim për Algjerinë shënon një moment historik dhe rrit presionin dhe emocionin për edicionin e ardhshëm të Kupës së Botës, ku ekipi afrikan do të kërkojë të lërë gjurmë në turneun më të madh botëror të futbollit.

MBAPPE: MEDIET SHPIKIN PËR TË NA NDARË MUA DHE VINICIUSIN

MADRID, 10 TETOR - Kylian Mbappe ka thyer heshtjen lidhur me marrëdhënien e tij me bashkëlojtarin te Real Madrid, Vinicius Junior, duke deklaruar se mediet janë përgjegjëse për spekulimet se dyshja nuk kanë marrëdhënie të mirë. Francezi beson se mediet "shesin shumë gazeta" duke përhapur narrativë të rreme për raportin e tyre, duke shtuar se nuk ka absolutisht asnjë problem me Viniciusin. Mbappe më në fund komplotoi transferimin e shumëpritur te Real Madridi në verën e vitit 2024, me "Los Blancos" që u kthye në

një nga skuadrat më të frikshme në Evropë falë partneritetit të mundshëm mes tij dhe Vinicius Jr. Megjithatë, muajt e parë të vështirë të Mbappes në La Liga përkuan me një rënie të madhe të formës së Viniciusit. Raportimet nga Spanja sugjeronin se marrëdhënia mes tyre nuk ishte "idhulllore". "Dy lojtarë të famshëm në të njëjtin ekip shesin shumë gazeta, shumë gjëra. Kam një marrëdhënie shumë të mirë me Viniciusin. Këtë vit është edhe më mirë, e kemi njohur njëri-tjetrin më mirë. Ai është një lojtar i shkëlqyer dhe si person, një njeri shumë i mirë. E dimë që



njerëzit flasin për ne për çdo gjë, por kemi të njëjtin qëllim: ta ndihmojmë Real Madridin të fitojë tituj. Mendoj se, nëse

duam të fitojmë tituj, duhet të japim më të mirën dhe ta ndihmojmë ekipin në tërësi", ka thënë Mbappe.

Dyshja e ka nisur sezonin 2025/2026 në mënyrë fantastike, duke shkaktuar dëme të mëdha në mbrojtjet kundërshtare. Mbappe ka shënuar 14 gola në 10 paraqitjet e para, duke mos realizuar vetëm në një ndeshje. Ndërkohë, Viniciusi ka kontribuar me pesë gola dhe katër asistime në La Liga. Së bashku ata kanë dhënë 25 kontribute direkte në gola, duke kombinuar për të shënuar në tre nga tetë ndeshjet e kampionatit, një përmirësim i dukshëm nga sezoni i kaluar, kur ishin të dy në listën e realizatorëve në vetëm katër nga 26 ndeshje të La Ligas.

Mesfushori Medon Berisha kërkohet në La Liga

Tiranë, 10 tetor - Edhe pse nuk është periudhë për shitjen e blerjen e lojtarëve, për futbollistin shqiptar në formë, Medon Berisha, kanë filluar interesimet e para. Sipas asaj

që shkruajnë mediet në Spanjë e Itali, Real Sociedadadi është interesuar për mesfushorin shqiptar të Lecces, Medon Berisha. Klubi bask ka kërkuar informacion

për Berishën dhe po planifikon ndonjë lëvizje konkrete. Paraqitjet e lojtarit të kombëtares shqiptare kanë impresionuar drejtuesit e skuadrës nga La Liga

spanjolle, me këta të fundit që e shikojnë afrimin e 21-vjeçarit si të nevojshëm qysh në janar të vitit të ri. Medon Berisha ka luajtur 4 ndeshje në këtë sezon me Leccen.





U prilog članu 8, članu 10 pod st. 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.12.2010, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, člana 18 i člana 22 Pravilnika br. 13/25 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta, donijetog od strane Upravnog odbora N.P.L. "Përpärimi" Sh. A a na osnovu rješenja br. protokola 1836/25 od 09.10.2025, godine glavnog izvršnog direktora, N.P.L. "Përpärimi" Sh. A od 09.10.2025, saopštava:

JAVNI KONKURS

I. Naslov: Recepcioner – Čuvar

Broj izvršilaca: 2

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja

Stručna priprema: Srednja ili osnovna škola

Radno iskustvo: Poželjno šest (6) meseci

Izvršava: Rukovodiocu jedinice recepcionera – čuvara

Koeficijent plate: 390.00 Euro Bruto

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Sposobnost za obavljanje posla u punom radnom vremenu bez ograničenja;
- Evidentira posetioce i vodi evidenciju o ulascima i izlascima iz objekta, istovremeno čuva imovinu objekta koji obezbeđuje;
- U slučaju opasnosti odmah obaveštava nadležne osobe;
- Kontrolise prtljag i sumnjive predmete;
- Po potrebi može biti raspoređen i na drugo mesto za recepciju – čuvara;
- Obavezan je koristiti sva propisana sredstva za zaštitu na radu;
- Mora znati koristiti protivpožarna sredstva;
- Ima pristup sigurnosnim kamerama uz prethodnu saglasnost institucije;
- U slučaju požara, evakuacije ili drugih pretnji, upućuje ljude da prate protokole bezbednosti;
- Odgovara za svoj rad Rukovodiocu jedinice recepcionera – čuvara;
- Obavlja i druge zadatke po nalogu menadžmenta preduzeća.

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Prijavni obrazac za N.P.L. "Përpärimi" Sh. A - Vučitrn. (skenirano);
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

> Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

> Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

> Dokumenti koji se zahtevaju pre zasnivanja radnog odnosa:

- Uverenje o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Lekarsko uverenje.

> Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od 10.10.2025 do 24.10.2025 u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijava kandidata najkasnije do 03.11.2025.
- Rok za žalbu je od 04.11.2025 do 06.11.2025.
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do 17.11.2025.
- Rok za žalbu je od 18.11.2025 do 20.11.2025.
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do 27.11.2025.
- Rok za žalbu je od 28.11.2025 do 02.12.2025.

- Objavljivanje konačnih rezultata za uspešnog kandidata najkasnije do 12.12.2025.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

> Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu N.P.L. "Përpärimi" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaje se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

> Objašnjenje

Preduzeće ima za cilj da pojasni pitanje termina koji se koriste u rodnom aspektu, pri čemu reči i titule jednog roda uključuju i drugi rod.

> ZAKLJUČAK

NPL "Përpärimi" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Great Plains L.L.C – Prishtinë me nr. të protokolit 5210/25 të datës 04.07.2025 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet parku solar dhe infrastruktura përcjellëse dhe ndodhen të gjitha në Zonën Kadastrale Lubovë 70806030, me numër të parcelave: 00015-3; 00016-0; 00018-0; 00019-0; 00020-0; 00029-1; 00029-2; 00029-3; 00030-1; 00030-2; 00030-3; 00030-4; 00030-5; 00030-6; 00030-7; 00030-8; 00035-0; 00036-0; 00037-1; 00037-2; 00038-0; 00039-0; 00040-0; 00041-1; 00041-2; 00043-3; 00044-0; 00045-0; 00046-1; 00046-2; 00047-1; 00047-2; 00048-0; 00049-1; 00049-2; 00049-3; 00055-0; 00056-1; 00056-2; 00057-1; 00057-2; 00057-3; 00058-0; 00068-0; 00069-0; 00070-0; 00071-0; 00072-1; 00072-2; 00078-1; 00078-2; 00078-3; 00078-4; 00079-0; 00081-0; 00082-0; 00084-0; 00085-0; 00358-0; 00359-0; 00360-0; 00361-1; 00361-2; 00362-1; 00363-1; 00363-3; 00365-0; 00366-0; 00367-0; 00370-0; 00371-0; 00372-0; 00373-2; 00373-3; 00381-0; 00382-0; 00383-0; 00384-0; 00385-1; 00385-2; 00387-1; 00387-2; 00387-3; 00387-4; 00387-5; 00387-6; 00387-7; 00388-1; 00388-2; 00388-3; 00520-3; 00521-0; 00523-0; 00524-1; 00525-0; 00536-0; 00538-2; 00539-1; 00539-2; 00539-3; 00539-4; 00546-1; 00546-2; 00546-5; 00547-0; 00548-0; 00549-0; 00550-1; 00550-2; 00551-0; 00552-1; 00552-2; 00552-4; 00552-5; 00553-0; 00555-1; 00555-3; 00556-0; 00557-0; 00558-0; 00559-0; 00560-1; 00563-2; 00565-2, me sipërfaqe totale prej 109.838 m² që ndodhen në Komunën e Istogut.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Impianti fotovoltaiik “Parkut Fotovoltaiik në Lubovë 100 MW” Z.K. Lubovë- Istog” për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji diellore.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.24.10.2025 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara: Kushtet Ndërtimore të propozuara: Great Plains L.L.C	
Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Arë e klasës 5, 6 dhe 7/ Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga Dielli	
b. Vija rregulluese.	- m’
c. Vija e ndërtimit.	5-7 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	2.5-3.0 m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	2.5-3.0 m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	0.18 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	91.63 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	7
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Montuese
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Elektro & Hidro Term B.N” Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812211283 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Elektro & Hidro Term B.N” D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812211283 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Elektro & Hidro Term B.N” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 812211283 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Argjend Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e Furrës së bukës.

- “Kalaja”, Sh.P.K me numër Unik identifikues: 810246159 shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me numër: 330008921.

- Fazli Buduri shpall të pavlefshme diplomën e QK “11 Marsi”, Prizren.

- Leonida Deda nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme të ultë “Lush Marku” Brekoc, Gjakovë.

- Xhenajeva Trans shpall të pavlefshme certifikatën e Export-Import me numër: 330271180.

- Berat Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Luigj Gurakuqi” Nashec.

- Florind Gurazi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K “11 Marsi” Prizren.

- “Vr Digital Agency” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811430686.

- “Reisa 2022” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330514530.
- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

